



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:108786

Datë: 05.02.2021

Numri i dokumentit: 01479882

C.nr.912/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore, e përbërë nga gjyqtari individual Naim MEHOLLI dhe me procesmbajtësen Elheme PEÇI, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit më shkrim e përfaqëson F.SH, avokat në Mitrovicë, kundër të paditurës S... në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson Mr.Sc. L.B, Shefe e Zyrës Ligjore, baza e kontestit: kompensim të pagesës së shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 688.69 euro, pas mbajtjes së seancës kryesore publike me datë 04.02.2021, me datë 05.02.2021 bie këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit A.M nga Mitrovica, kundër të paditurës S... në Mitrovicë, **si e bazuar**;
- II. **OBLIGOHET** e paditura S... në Mitrovicë që paditësit A.M nga Mitrovica, në emër të shpërblimit jubilar për dhjetë (10) vite të përvojës së punës, t'ia kompensoj 1 (një) pagë në shumën e përgjithshme prej **688.69 euro (me fjalë: gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë euro e gjashtëdhjetë e nëntë cent)** në afat prej shtatë (7) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
- III. **OBLIGOHET** e paditura S... që në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia kompensoj paditësit shumën e përgjithshme prej **259 euro (me fjalë: dyqind e pesëdhjetë e nëntë euro)**, në afat prej shtatë (7) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, avokat F.SH, me datë 04.09.2020 ka ushtruar padi, me të cilën ka kërkuar shpërblimin jubilar për 10 (dhjetë) vite të përvojës së punës në vlerë të një page bazë dhe atë shumën e përgjithshme prej 688.69 euro, konform nenit 17 paragrafi 3 nënpar.3.1 të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 11.06.2018.

Gjykata, me datën 04.02.2021, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën për shqyrtim kryesor, në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësit dhe përfaqësuesja e të paditurës.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe precizimeve të bëra, duke deklaruar se gjatë procedurës provuese, në mënyrë të pakontestueshme u vërtetua bazueshmëria e kërkesëpadisë së precizuar, andaj gjykatës i propozon që të njejtën t'a aprovoj në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i kërkon dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104 euro, në emër të përfaqësimit në seancë gjyqësore shumë prej 135 euro si dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 20 euro

E paditura, përmes të të autorizuarës së saj, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, nuk e kontestoi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, gjithashtu e njehta nuk kundërshtoi përvojën e punës së paditësit dhe as lartësinë e pagës së paditësit.

Gjendja faktike e vërtetuar

Më qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor me propozimin e palëve ndërgjyqëse, administroi provat si në vijim: Kontratën e punës të paditësit e datës 08.12.2017; Kopja e letërnjoftimit të paditësit; Lista e pagës për muajin tetor 2020; Vërtetimi i lëshuar nga QKMF “...” të datës 10.08.2020, me numër të protokollit 651; Vërtetimi i lëshuar nga e paditura për paditësin me datë 10.08.2020, me numër të protokollit 1431; Kontrata për financimin e shkollimit specialistik e datës 01.10.2012.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën Kontestimore (tash e tutje referuar si LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbi këtë bazë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit **është në tërësi e bazuar**.

Nga Vërtetimi i datës 10.08.2020 me numër të protokollit 651, i lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “...” në Mitrovicë, vërtetohet se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në këtë institucion që nga data 01.07.2010 e deri më 30.09.2012. Po ashtu, nga Kontrata për financimin e shkollimit specialistik e lidhur me datë 01.10.2012 ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë në njërin anë dhe paditësit në anën tjetër, vërtetohet se paditësi ka përfunduar specializimin me pagesë në QKUK-Prishtinë në drejtimin Kirurgji e Përgjithshme. Gjithashtu, nga Kontrata e punës e datës 08.12.2017, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës si dhe Vërtetimit të datës 10.08.2020 me numër të protokollit 1431, të lëshuar nga e paditura për paditësin, vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura nga data 11.12.2017 ku edhe vazhdon të punojë.

Nga vërtetimet e lartëshënuara mbi përvojën e punës, si dhe nga kontratat në fjalë, gjykata ka konstatuar në mënyrë të padyshimt se paditësi është në marrëdhënie pune ne institucionet shëndetësore për më shumë se 10 vite, po ashtu përfaqësuesja e te paditurës nuk e ka kontestuar faktin se paditësi i ka 10 vite provoj pune.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, u referua në vlerën e pagës së fundit të paditësit, e cila vërtetohet në bazë të pasqyrës së pagës të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për muajin tetor 2020, lidhur me lartësinë e pagës bazë për paditësin.

Baza ligjore

Me nenin 4 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës parashihet se *“Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”*. Ndërsa, në nenin 90 i këtij ligji parashihet se *“1. Marrëveshja kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. në nivel të vendit, 2.2 nivel të degës; 2.3. nivel të ndërmarrjes. 3. Marrëveshja Kolektive mund të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”*.

Me nenin 4 paragrafi 1, të Kontratës Kolektive Sektoriale, (tash e tutje referuar si “Kontrata Kolektive”) parashihet që *“KKS-ja gjen zbatim në rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivelet e sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tërësor”, dhe paragrafi 2 “Fushë zbatimi i KKS-së ushtron efekt tek punëtorët shëndetësor dhe administrativ në institucione shëndetësore”*.

Gjithashtu, me nenin 17 paragrafi 3 i Kontratës Kolektive parashihet se *“punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, [...] për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij”*. Kurse, paragrafi 4 i po të njëjtit nen përcakton se *“Punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimet jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi ishte dhe vazhdon të jetë në marrëdhënie pune tek e paditura. Nuk ishte kontestues as fakti se i njëjti ka përvojë pune për më shumë se (10) vite.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet në tërësi si e bazuar. Kjo ngase në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësi ka qenë dhe vazhdon të jetë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se paditësi ka përvojë pune mbi njëzet (10) vite tek e paditura. Në rastin konkret, gjykata gjatë vendosjes lidhur me këtë çështje vlerësoi nenin 4 paragrafët 1 dhe 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale, përmbajtja e të cilëve u paraqit më lartë.

Gjykata vendimin e vet e bazoi në nenin 17, paragrafin 3, nënpar. 3.1 të Kontratës Kolektive Sektoriale e cila përcakton se *“punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë, [...] 3.1. për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësor, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij”*. Rrjedhimisht, të paditurës i takon kompensimi i vetëm një page jubilarë në shumë prej 688.69 euro.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve në shumën prej 104 euro për përpilim të padisë, për përfaqësim në seancë gjyqësore shumën prej 135 euro dhe në emër të taksës për padi shumën prej 20 euro.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 paragrafin 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.912/2020, më datë 05.02.2021

GJYQTARI
Naim MEHOLLI

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.